



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	
Nr.	prot.

Data: 11.2.2025

Nr: 76

Ora: 15:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN E RAPORTIT MBI VEPRIMTARITË PUBLIKE PËR PERIUdhËN 02 SHKURT-08 SHKURT 2025**

Sot, më datë 11.02.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

**OBJEKT:** Shqyrtimi i raportit mbi veprimtaritë me karakter publik të disa institucioneve për periudhën 02 shkurt deri më 08 shkurt 2025.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**V E N D O S:**

1. Miratimin e raportit të gjetjeve mbi veprimtaritë publike për periudhën 02 shkurt deri më 08 shkurt 2025, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë.
3. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Prefektit të Qarkut Shkodër.
4. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Data: 11.2.2025 Nr: 76  
Ora: 15:00



“Për shqyrtimin e raportit mbi veprimtaritë publike për periudhën 02 shkurt – 08 shkurt 2025”

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



## **RAPORTI I GJETJEVE**

### **MBI**

### **VEPRIMTARITË ME KARAKTER PUBLIK TË DISA INSTITUCIONEVE, PËR PERIUDHËN 02 SHKURT-08 SHKURT 2025**

Në lidhje me raportimet e veprimtarive publike në Ndërfaqen e Raportimeve të Institucioneve (NRI), për periudhën 02 shkurt-08 shkurt 2025, konstatohet si vijon:

- 8 institucione publike të reja janë regjistruar gjatë kësaj periudhe në NRI, dhe kanë akses për raportimin e veprimtarive,
- **313 raportime** janë kryer **në total**,
- 310 postime janë aktive,
- 3 janë të ndaluara

Për datat **02 shkurt-08 shkurt 2025**, në ndërfaqen e raportimeve janë ndaluar 3 veprimtari të raportuara nga institucione, për shkak të tejkalimit të afatit ligjor, si më poshtë vijon:

- **Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:
  - “Rend Publik”- Takim sensibilizues në kuadrin e marrjes së masave për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike për vitin 2025, raportuar në datën 03.02.2025 për t’u zhvilluar në datën 04.02.2025.
- **Prefekti i Qarkut Shkodër** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:
  - “Analiza vjetore e institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër”, raportuar në datën 03.02.2025 për t’u zhvilluar në datën 06.02.2025.
- **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2, e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:
  - “Infrastrukturë”- Inspektim i punimeve për segmentin Sop - Ura e Darëzezës, raportuar në datën 05.02.2025 për t’u zhvilluar në datën 05.02.2025.

Veprimtaria e raportuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është raportuar gabimisht me datë zhvillimi 05.02.2025, dhe është riraportuar menjëherë, pas raportimit të parë, me datën e saktë të zhvillimit 05.03.2025. Gjithashtu, personi i kontaktit ka njoftuar nëpërmjet postës

elektronike që e ka hedhur gabimisht muajin shkurt dhe sapo e ka konstatuar, e ka riraportuar me datën e saktë. Në këto kushte nuk jemi para kundërvajtjes administrative dhe sugjerojmë mosfillimin e shqyrtimit administrativ.

KQZ është në monitorim të vazhdueshëm të këtij procesi dhe në vijimësi do duhet që të gjithë institucionet shtetërore të kryejnë raportimet në lidhje me veprimtaritë që planifikohen të zhvillohen prej tyre, të paktën 5 ditë para zhvillimit të tyre dhe në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar.